



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 167/3 Prot.

Tiranë, më 29/2 /2012

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin “Universiteti Luarasi” Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 6, datë 29/02 2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Universiteti Luarasi” Tiranë.

KONSTATOVA

Ne periudhën 08-15.02.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, “Universiteti Luarasi” Tiranë me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi “Universiteti Luarasi” Tiranë për kategorinë e subjekteve të të dhënave “student”.
- Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave “student” bazuar në nenet 12, 13, 18 dhe 19 të ligjit nr .9887 datë 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave personale, bazuar në nenet 20, 27 dhe 28 të ligjit nr .9887 datë 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe bazuar në udhëzimin nr.4 datë 16/03/2010 ‘Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara, vëren se:

- 1) Kontrolluesi “Universiteti Luarasi” Tiranë në “Formularin e Aplikimit” për praninë të studentëve dhe në “Kontratën e Regjistrimit”, nuk ka informuar subjektet e të dhënave personale “studentë”, për qëllimin e përpunimit të të dhënave personale dhe me informacione të tjera të nevojshme që garantojnë përpunimin e drejtë të të dhënave personale.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një detyrim i rëndësishëm për kontrolluesit pasi subjektet e të dhënave duhet të dinë se çfarë bëhet me të dhënat personale të tyre, qëllimet për të cilat ato mbledhen nga kontrolluesi, mënyrën e përpunimit, ruajtjen dhe përhapjen e të dhënave të tyre. Kontrolluesi është i detyruar të

informojë subjektet e të dhënave personale para mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale. Informimi i studentëve duhet të realizohet në mënyrë të plotë dhe të hollësishme gjatë procedurave të regjistrimit të tyre që në momentin e mbledhjes së këtyre të dhënave.

Në këto kushte vlerësoj se janë shkelur:

- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neni 18 pika 1, sipas të cilit "*Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, e,ri dhe adresa e kontrolluesit dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm, për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale*".
 - Udhëzimi nr. 4 datë 16/03/2010, "*Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit*", sipas të cilit "*Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të informohet në lidhje me të dhënat të cilat i përpunohen përfshirë dhe transferimin. Informimi i subjektit të të dhënave përfshin qëllimin e përpunimit, kategoritë e marrësve si dhe çdo informacion tjetër që është i nevojshëm për të garantuar përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm*".
 - Vendimi nr. 2 datë 10/03/2010 "*Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre, kreu II pika 2.*
- 2) Kontrolluesi "Universiteti Luarasi" Tiranë nuk ka hartuar një Rregullore të veçantë lidhur me mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Hartimi i një Rregulloreje të veçantë është një pjesë e rëndësishme e masave bazë të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi. Në këtë rregullore përcaktohen mekanizma për kontrollin e aksesit, identifikimin e saktë të çdo përdoruesi të të dhënave, garantimin që informacioni i mbledhur do të përdoret sipas rregullave të mirëpërcaktuara. Me anën e kësaj Rregulloreje duhen përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit, procedurat e përpunimit, sistemin e arkivimit, etj, si dhe politika të veçanta për ruajtjen e konfidencialitetit. Një rregullore e tillë është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjektit të të dhënave (studentëve) gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur neni 27 pika 1 i Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, sipas të cilit "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*"... "*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*".

Gjithashtu, vlerësoj se është shkelur neni 27/2 "c" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" : "*udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave*", si dhe mungojnë politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet konfidencialitetit, të parashikuara në Nenin 28 të Ligjit.

Përsa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe neneve 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 pika 1 germa “c” të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Pikës 2 të Udhëzimit Nr. 4, datë 16/03/2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit” dhe Kreut II, pika 2 të Vendimit Nr. 2, datë 10/03/2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre, në “Formularin e Aplikimit” për pranimin e studentëve dhe në “kontratën e regjistrimit”, të realizohet informimi i plotë i subjekteve të të dhënave personale “studentë”, për qëllimin e përpunimit të të dhënave personale dhe me çdo informacion tjetër të nevojshme që garanton përpunimin e drejtë të të dhënave personale, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh.
2. Në zbatim të neneve 27/2 “c” dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartohet një Rregullore e Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh. Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj për hartimin e kësaj Rregulloreje.
3. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit” *Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

